



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.311/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Koalicioni LDK-AK, paraqitur kundër komisionarëve të QV-1914E/04D, lidhur me bartjen e votave të subjektit tjetër, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 15.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Hudhet si palejuar** apeli Anr.311/2017 e datës 12.06.2017, e parashtruar nga Koalicioni LDK-AKR.

## A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Koalicioni LDK-AKR në të cilën pretendohet se në vendvotimin 1914E/04D gjatë futjes së të dhënave në sistem gabimisht votat e Koalicionit LDK-AKR i janë bartur Gragjanska Iniciativa Gore. Parashtruesi i PZAP-it kërkon që të bëhet përmirësimi i të dhënave të futura në sistem ose të bëhet hapja e kutisë dhe të numërohen edhe njëherë votat. Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmitarit ka shënuar emrin e komisionerit të VV si dhe dy vëzhguesve, po ashtu ankesës ia ka bashkangjitur raportin e vëzhguesve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati preliminar nuk është shpallur nga KQZ-ja dhe se mund të ndryshoj në çdo moment, po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare të QNR-së palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.


Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, ne të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe te pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.311/2017 më datën 13.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit**

Rafet Haxhaj



***Këshillë Juridike:***

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.